

LIGJI NR. 08/L-229

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR ZBATIMIN E NDËRSJELLË TË AKTGJYKIMEVE NË ÇËSHJTET PENALE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR ZBATIMIN E NDËRSJELLË TË AKTGJYKIMEVE NË ÇËSHJTET PENALE

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë për Zbatimin e Ndërsjellë të Aktgjykimeve në Çështjet Penale, të nënshkruar nga Ministrat e Drejtësisë të të dy vendeve më datë 28.10.2016 në Slloveni.

Neni 2

Fushëveprimi

Ky ligj vlen për të gjitha organet e administratës shtetërore dhe organet gjyqësore në Kosovë që janë përgjegjëse për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

Neni 3

Dokumentet e bashkëngjitura

Në shtojcën e këtij ligji është bashkëngjitur teksti i Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë për Zbatimin e Ndërsjellë të Aktgjykimeve në Çështjet Penale.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-229

8 qershor 2023

Shpallur me dekretin Nr. DL-115/2023, datë 22.06.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu

*Ligji nr. 08/L-229 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë për Zbatimin e Ndërsjellë të Aktgjykimeve në Çështjet Penale." bashkangjitur me marrëveshje janë publikuar në web faqen e Gazetës Zyrtare (gzk.rks-gov.net)

MARRËVESHJE

NDËRMJET

REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

REPUBLIKËS SË SLLOVENISË

PËR ZBATIMIN E NDËSJELLË TË AKTGJYKIMEVE NË ÇËSHTJET PENALE

Republika e Kosovës dhe Republika e Sllovenisë (më tutje "Palët),

të vetëdijshëm për nevojën e përmirësimit të mëtejshëm të besimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e drejtësisë;

duke pasur parasysh se një bashkëpunim i tillë duhet çuar më tej qëllimet e drejtësisë dhe rehabilitimin social të personave të dënuar;

duke pasur parasysh se ky qëllim mund të arrihet më së miri duke zbatuar dënimet penale në shtetin e vendbanimit të përhershëm të personit të dënuar apo të nënshtetësisë së tij;

kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I PARË

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Palët bien dakord që, sipas kërkesës, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga kjo Marrëveshje, të zbatojnë aktgjykimet e formës së prerë në çështjet penale të lëshuara nga një gjykatë e njërës prej Palëve kundër një shtetasi të Palës tjetër ose kundër një personi që banon në territorin e saj, duke:

1. marrë përsipër zbatimin e dënimeve me burgim dhe masave të tjera që përfshijnë privimin nga liria;
2. marrë përsipër mbikëqyrjen e personave të cilëve u është shqiptuar një dënim me kusht për një periudhë kohe gjatë periudhës provuese.

Neni 2

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

1. "Shteti Dënues" nënkupton Pala në të cilën është lëshuar aktgjykimi që duhet zbatuar apo mbikëqyrur;
2. "Shteti Zbatues" nënkupton Pala në të cilën zbatohet aktgjykimi i lëshuar nga Pala tjetër;

3. "Masa tjera të cilat përfshijnë privimin nga liria" janë ato masa edukative dhe të sigurisë të parashikuara nga legjislacioni penal i Palëve të cilat rezultojnë me privimin nga liria;

4. "Dënimi me kusht" nënkupton dënim me kusht dhe dënim me kusht me mbikëqyrje kujdestare, siç parashihet në legjislacionin penal të Palëve.

Neni 3

(1) Gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve do të komunikojnë me shkrim - Republika e Kosovës përmes Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës dhe Republika e Sllovenisë përmes Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Sllovenisë.

(2) Kanalet diplomatike nuk do të përjashtohen, nëse ka baza të arsyeshme për to.

(3) Në raste urgjente, autoritetet kompetente të secilës palë mund të dërgojnë kërkesat dhe njoftimet sipas kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL).

Neni 4

(1) Kërkesat dhe dokumentacioni Republikës së Kosovës i përcillen në gjuhën shqipe, serbe apo angleze, dhe Republikës së Sllovenisë i përcillen në gjuhën sllovene dhe angleze.

(2) Legalizimi i dokumenteve të cekura në paragrafin 1 të këtij neni, nuk është i nevojshëm.

Neni 5

(1) Zbatimi ose mbikëqyrja, sipas kësaj Marrëveshjeje, ndërmerret nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

1. nëse personi i dënuar është shtetas apo banues i Shtetit Zbatues;
2. nëse aktgjykimi është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm;
3. nëse personi i dënuar jep pëlqimin për këtë;
4. nëse vepra e cila është bazë e aktgjyqimit përfundimtar konsiderohet si vepër penale sipas ligjeve të të dyja Palëve;
5. nëse shteti që ka shqiptuar dënimin dhe shteti që ka marr përsipër zbatimin bien dakord për transferimin e zbatimit apo mbikëqyrjes.

(2) Transferimi i zbatimit, duke përfshirë transferimin e një personi, është i mundur nëse kohëzgjatja e dënimit që personi i dënuar ka për të vuajtur është jo më pak se gjashtë muaj nga data e paraqitjes së kërkesës. Përjashtimisht, Palët mund të bien dakord për transferimin e zbatimit edhe nëse kohëzgjatja e dënimit penal që personi i dënuar ka për të vuajtur është më e shkurtër se gjashtë muaj.

(3) Nëse kohëzgjatja e dënimit nuk është përcaktuar, për tu vlerësuar nëse kjo kohë është më e shkurtër se gjashtë muaj, duhet të merret parasysh periudha kohore më e gjatë pas së cilës masa duhet të anulohet në përputhje me ligjin e Shtetit Dënues.

(4) Nëse personi i dënuar nuk mund të japë pëlqimin e vlefshëm ligjor për transferimin e mbikëqyrjes ose zbatimit, është e nevojshme marrja e pëlqimit nga përfaqësuesi i tij ligjor sipas ligjit të shtetit në të cilin ai ose ajo banon.

(5) Pëlqimi të cilit i referohet pika 3, paragrafi 1 i këtij neni nuk kërkohet nëse personi ka shmangur zbatimin ose ekzekutimin e mëtejshëm të dënimit me ardhjen e tij në ose me ikjen e tij në shtetin e kërkuar.

Neni 6

Zbatimi apo mbikëqyrja nuk do të ndërmerren:

1. kur zbatimi ose mbikëqyrja do të ishin në kundërshtim me parimet themelore të sistemit juridik të shtetit të kërkuar;
2. në qoftë se vepra e cila është bazë e aktgjyqimit të plotfuqishëm, konsiderohet nga shteti i kërkuar të jetë e një natyre politike ose ushtarake;
3. nëse zbatimi ose mbikëqyrja janë në kundërshtim me obligimet tjera ndërkombëtare të shtetit të kërkuar;
4. nëse procedura penale për të njëjtën vepër penale është duke u zhvilluar kundër personit të dënuar në shtetin e kërkuar;
5. kur shteti i kërkuar nuk është në gjendje të zbatojë dënimin për shkak të vjetërsimit;
6. kur personi i dënuar, duke pasur parasysh moshën e tij/saj në kohën e kryerjes së veprës, nuk ka mundur të ndiqet penalisht në shtetin e kërkuar;
7. nëse personi i dënuar tashmë është dënuar ose liruar për të njëjtën vepër penale me aktgjykim të formës së prerë, ose procedura penale kundër këtij personi përfundimisht ka pushuar apo akuza kundër këtij personi ka pushuar me vendim të formës së prerë;
8. nëse aktgjykimi është shqiptuar në mungesë;
9. nëse aktgjykimi është lëshuar nga një gjykatë e jashtëzakonshme;
10. nëse aktgjykimi i cili shqipton dënimin me heqje të lirisë, pavarësisht paragrafit të dytë të nenit 11 të kësaj Marrëveshjeje, nuk mund të zbatohet nga shteti i kërkuar në përputhje me sistemin e tij ligjor ose sistemin e kujdesit shëndetësor.

Neni 7

- (1) Shteti i kërkuar, pa vonesë, do të informojë shtetin kërkuar për pranimin apo refuzimin e kërkesës për marrjen e zbatimit apo mbikëqyrjes.
- (2) Në rast të refuzimit të plotë apo të pjesshëm të marrjes së zbatimit apo mbikëqyrjes, shteti i kërkuar do të specifikojë arsyet e këtij refuzimi.

Neni 8

- (1) Zbatimi do të kryhet ekskluzivisht vetëm në bazë të ligjit të Shtetit Zbatues.
- (2) Secila Palë mund të falë apo të amnistoj personin e dënuar.
- (3) Vetëm Shteti Dënues ka juridiksion për të vendosur për mjetet e jashtëzakonshme juridike.
- (4) Nëse kërkesa për ekzekutim është e bazuar në një aktgjykim që më pas është shfuqizuar ose plotësuar në Shtetin Dënues, ky i fundit do të njoftojë menjëherë Shtetin Zbatues lidhur me këtë. Në bazë të vendimit të ri, gjykata e Shtetit Zbatues vendos për vuajtjen e mëtejshme të dënimit me burg apo të masave tjera që përfshijnë heqjen e lirisë sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.
- (5) Palët informojnë njëra-tjetrën për vendimet e referuara në paragrafët dy dhe tre të këtij neni.

Neni 9

Vendi, koha dhe mënyra e dorëzimit të personit të dënuar përcaktohet në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve.

KAPITULLI I DYTË

Zbatimi i Dënimit Neni 10

- (1) Në qoftë se një person i cili është shtetas i njëjës Palë, ose një person që ka vendbanim në territorin e saj, është dënuar për një vepër penale me dënim me burg ose masë tjetër që përfshin heqjen e lirisë në Palën tjetër, secila palë mund të kërkojë që zbatimi i dënimit me burgim ose masë tjetër që përfshin heqjen e lirisë, të transferohet në Palën e nënshtetësisë apo vendbanimit të personit të dënuar.
- (2) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit të parë të këtij neni, vetëm Shteti Dënues mund të kërkojë zbatimin e një dënimi me burg ose përfshirjen e masës tjetër të heqjes së lirisë, nëse transferimi i zbatimit të një dënimi nuk përfshinë edhe transferimin e personit.
- (3) Për zbatimin e një vendimi që përfshin transferimin e një personi, kjo Marrëveshje nuk përjashton të drejtën e personit të dënuar, përfaqësuesit të tij ligjor, bashkëshortëve, partnerëve bashkëjetues, të afërm në një linjë të drejtpërdrejtë, vëlla ose motër, të paraqesin kërkesë për transferimin e zbatimit në gjykatën e cila e ka lëshuar vendimin ose me autoritetin kompetent të Shtetit Dënues ose të shtetit të nënshtetësisë ose të vendbanimit të personit të dënuar.
- (4) Gjykata ose organi kompetent i Shtetit Dënues e informon personin e dënuar për mundësinë e vuajtjes së dënimit me burg ose masë tjetër që përfshin heqjen e lirisë në shtetin e nënshtetësisë apo vendbanimit të tij.

Neni 11

- (1) Gjykata e shtetit Zbatues, në përputhje me ligjin e saj, përcakton dënim të mbikëqyrur ose masë tjetër që përfshin heqjen e lirisë që duhet të zbatohet, ku ajo është e lidhur me gjendjen faktike që përmban aktgjykimi dhe duhet të marrë në konsideratë dënimin me burg ose masë tjetër që përfshin heqjen e lirisë të vendosur në Shtetin Dënues.
- (2) Kur dënim i me burg, ose masë tjetër që përfshin heqjen e lirisë, nuk është në pajtueshmëri me ligjin e Shtetit Zbatues sa i përket kohëzgjatjes, gjykata e Shtetit Zbatues mund të vendosë për të përshtatur dënimin vetëm nëse e tejkalon dënimin maksimal të ofruar nga vet ligji vendor për të njëjtën vepër penale. Në këtë rast, dënim i përshtatur nuk mund të jetë më pak se dënim i maksimal i parashikuar nga ligji i Shtetit Zbatues për të njëjtën vepër penale.
- (3) Kur dënim i me burg ose me masë tjetër që përfshin heqjen e lirisë nuk është për nga natyra në përputhshmëri me ligjin e Shtetit Zbatues, gjykata e Shtetit Zbatues mund ta përshtat atë në bazë të dënimit ose masës së parashikuar për të njëjtën vepër penale sipas legjislacionin të saj vendor. Një dënim ose masë e tillë duhet të jetë në përputhje sa më të madhe me dënimin që është lëshuar në Shtetin Dënues.
- (4) Dënim i pranuar nuk mund të jetë më i ashpër në natyrën e tij apo në kohëzgjatje se sa dënim i shqiptuar nga Shteti Dënues.
- (5) Koha e kaluar në një burg të Shtetit Dënues do të jetë në tërësi e përfshirë në dënimin e heqjes së lirisë ose të masave të tjera të cilat përfshijnë vuajtjen e heqjes së lirisë në Shtetin Zbatues.

Neni 12

- (1) Nëse aktgjykimi është i bazuar në disa vepra penale, transferimi i zbatimit mund të kërkohet vetëm për një pjesë të dënimit që lidhet me ndonjë nga këto vepra të veçanta.

- (2) Shteti Dënues përcakton pjesën e dënimit për të cilën kërkohet transferimi i zbatimit.
- (3) Nëse Shteti Dënues dështon në përcaktimin e pjesës së dënimit për të cilën kërkohet transferimi i zbatimit, ose dështon ta bëjë këtë brenda afatit të përcaktuar nga Shteti Zbatues, atëherë Shteti Zbatues përcakton, në bazë të ligjit të tij vendor, pjesën e dënimit që duhet zbatuar.

Neni 13

- (1) Marrë parasysh zbatimin e dënimit, zbatimi në Shtetin Dënues është i ndaluar. Nëse personi i dënuar është i burgosur në Shtetin Dënues, burgimi i tij zgjat deri në transferimin e tij në Shtetin Zbatues.
- (2) Shtetit Dënues i hiqet e drejta për ekzekutim, kur personi i dënuar ka mbajtur plotësisht dënimin me burg ose masat e tjera që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë në Shtetin Zbatues ose kur dënimi i tij është ndërprerë përfundimisht.
- (3) Shteti Dënues rimerr të drejtën e zbatimit, nëse personi i dënuar i shmanget vuajtjes së dënimit në Shtetin Zbatues. Shteti Zbatues informon Shtetin Dënues në lidhje me këtë.

KAPITULLI I TRETË

Mbikëqyrja

Neni 14

- (1) Me anë të një kërkesë sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje, Palët, në mënyrë reciproke mbikëqyrin personat gjatë periudhës provuese për të cilët njëra gjykatë e njërës palë ka lëshuar dënim me kusht.
- (2) Mbikëqyrja kryhet në Palën në të cilën personi i dënuar banon.

Neni 15

- (1) Mbikëqyrja kryhet vetëm në përputhje me ligjin e Palës që ka marr përsipër një mbikëqyrje e tillë.
- (2) Kur natyra ose kohëzgjatja e masës së mbikëqyrjes ose kohëzgjatja e periudhës provuese nuk përputhet me ligjin e shtetit Zbatues, ajo duhet të përshtatet në përputhje me natyrën ose kohëzgjatjen e masave mbikëqyrëse, ose kohëzgjatjen e periudhës provuese për të njëjtën vepër penale sipas legjislacionit të Shtetit Zbatues. Masa mbikëqyrëse ose kohëzgjatja e periudhës provuese duhet të përputhet sa më shumë që të jetë e mundur me masën ose kohëzgjatjen e periudhës provuese të përcaktuar nga Shteti Dënues.
- (3) Nëse masat mbikëqyrëse ose kohëzgjatja e periudhës provuese përshtaten, për shkak që kohëzgjatja e tyre tejkalon kohëzgjatjen maksimale sipas ligjit të Shtetit Dënues, kohëzgjatja e përshtatur e masës mbikëqyrëse ose periudhës provuese, nuk duhet të jetë më e shkurtër se kohëzgjatja maksimale e mundshme që parashihet për të njëjtën vepër penale nga ligji i Shtetit Zbatues.
- (4) Masat mbikëqyrëse të vendosura në Shtetin Zbatues nuk duhet të jenë më të rrepta sa i përket natyrës dhe kohëzgjatjes, se sa ato të vendosura në Shtetin Dënues.

Neni 16

Revokimi i dënimit me kusht është vetëm në kompetencat e Shtetit Dënues.

Neni 17

(1) Në bazë të kërkesës, e cila duhet të mbështetet nga dokumentacioni i referuar në nenin 20 të kësaj Marrëveshjeje, shteti i kërkuar, pa asnjë vonesë, informon shtetin kërkues nëse kërkesa e tij do të plotësohet.

(2) Shteti Zbatues informon Shtetin Dënues në lidhje me kushtet dhe masat mbikëqyrëse të çdo rrethane që mund të çoj deri tek revokimi i dënimit me kusht, dhe përfundimit të periudhës provuese.

Neni 18

(1) Shteti Dënues informon, pa asnjë vonesë, Shtetin Zbatues në lidhje me revokimin e dënimit me kusht.

(2) Nëse Shteti Dënues revokon dënimin me kusht, Shteti Zbatues mund të kërkoj marrjen e zbatimit të dënimit.

Neni 19

(1) Nëse për mbikëqyrje ndërrmirren masa të mëtejshme në lidhje me zbatimin e dënimit në Shtetin Dënues, atëherë ajo pezullohet përkohësisht.

(2) Shtetit Dënues i hiqet e drejta për zbatim, në qoftë se gjatë periudhës provuese nuk kanë ndodhur rrethana të cilat do të shpinin tek revokimi i dënimit me kusht, në bazë të ligjit të tij.

KAPITULLI I KATËRT

Dispozitat e përbashkëta procedurale

Neni 20

(1) Kur bëhet dorëzimi i kërkesës, ose me kërkesë të Shtetit Zbatues, Shteti Dënues siguron dokumentacionin e mëposhtëm:

1. origjinalin ose kopjen e vërtetuar e aktgjykimit me prova që tregojnë që është i formës së prerë, dhe, kur është nevoja, zbatueshmërinë e tij;
2. një kopje e tekstit të dispozitave ligjore të zbatuara;
3. informacione në lidhje me personin e dënuar, përfshirë këtu shtetësinë dhe vendbanimin e tij/saj;
4. dëshmi për çfarëdo lloj periudhe të burgimit ose masave tjera që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë, të cilat do të llogariteshin në dënim;
5. për aq sa është e mundur, një deklaratë e personit të dënuar që dëshmon pëlqimin e tij për transferimin e zbatimit ose mbikëqyrjes, përveç nëse në bazë të paragrafit të pestë të nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje, pëlqimi i tij nuk është i nevojshëm;
6. informacione të tjera që mund të jenë relevante për të marrë vendim në lidhje me kërkesën.

(2) Kur bëhet dorëzimi i kërkesës, ose me kërkesë të Shtetit Dënues, shteti Zbatues siguron dokumentacionin e mëposhtëm:

1. informacione në lidhje me personin e dënuar, përfshirë këtu shtetësinë dhe vendbanimin e tij/saj;
2. një kopje të dispozitave ligjore në fuqi;

3. informacione të tjera që mund të jenë relevante për të marrë vendim në lidhje me kërkesën.

Neni 21

(1) Nëse shteti i kërkuar i konsideron informacionet dhe dokumentacionin e paraqitur si të pamjaftueshme, ai kërkon plotësimin e tyre brenda një periudhe të arsyeshme, e cila mund të zgjatet me kërkesë të arsyetuar të shtetit kërkuar.

(2) Nëse kërkesa për plotësimin e tyre nuk plotësohet, vendimi mbi kërkesën për transferimin e zbatimit bëhet në bazë të informacioneve dhe dokumentacionit ekzistues.

Neni 22

(1) Në raste urgjente, shteti kërkuar mund të kërkojë ndalimin e përkohshëm me qëllim të sigurimit të Zbatimit, para se të parashtrohet kërkesa për njohjen dhe zbatimin e aktgjykimit.

(2) Kërkesa duhet të përmbajë:

1. të dhënat e nevojshme për përcaktimin e identitetit të personit të dënuar;
2. përshkrimin e fakteve dhe cilësimit të veprës;
3. të dhëna mbi ekzistencën e vendimit përfundimtar të dënimit;
4. një deklaratë që tregon se kërkesa do të dorëzohet.

(3) Nëse shteti i kërkuar nuk pranon kërkesën brenda 18 ditësh nga data e ndalimit të përkohshëm, atëherë ndalimi përfundon. Nëse ka ndonjë kërkesë të arsyeshme në këtë drejtim, ndalimi mund të zgjatet në një maksimum prej 40 ditë pas datës së urdhrin për ndalim.

(4) Shteti i kërkuar mund të urdhëroj ndalimin e personit të dënuar, nga data e pranimit të kërkesës, deri tek përfundimi i procedurave për ekzekutimin e kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e aktgjykimit, në përputhje me ligjin e vet.

Neni 23

Shteti Zbatues informon Shtetin Dënues:

1. kur dënimi është zbatuar;
2. në rast se personi i dënuar shmang zbatimin e dënimit;
3. në rast se Shteti Dënues kërkon një raport të veçantë.

Neni 24

(1) Njëra palë, me kërkesën e palës tjetër, lejon kalimin tranzit të personit të dënuar që shteti i tretë është duke e transferuar tek pala që kërkon tranzitin. Shteti i kërkuar nuk është i detyruar të lejojë kalimin transit të qytetarëve ose personave të tij të cilët kanë qenë të dënuar për vepra penale ushtarake ose politike.

(2) Kërkesat dhe mënyra e tranzitit dhe shpenzimeve rregullohet me anë të marrëveshjes së përbashkët të autoriteteve kompetente të palëve.

Neni 25

(1) Shpenzimet e kryera në transferimin e personit të dënuar me qëllim të zbatimit të dënimit, mbulohen nga Shteti Zbatues, përveç në ato raste kur këto shpenzime janë bërë në Shtetin Dënues.

(2) Shteti që kërkon që transferimi i personit të dënuar të bëhet me aeroplan, mbulon shpenzimet e këtyre procedurave.

Neni 26

Kjo Marrëveshje zbatohet për aktgjykimet e plotfuqishme të lëshuara para hyrjes së saj në fuqi.

KAPITULLI I PESTË

Dispozitat finale

Neni 27

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, zgjidhet nëpërmjet konsultimeve ndërmjet autoriteteve kompetente ose nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 28


- (1) Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të ardhshëm, pas datës së pranimin të njoftimit të fundit me shkrim, me anë të së cilës Palët njoftojnë njëra tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se procedurat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi kanë përfunduar.
- (2) Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhe të pacaktuar kohore. Secila Palë mund ta ndërprejë Marrëveshjen me anë të një njoftimi me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të përfundojë gjashtë muaj pas marrjes së këtij njoftimi me shkrim për ndërprerjen e saj.
- (3) Pas ndërprerjes, kjo Marrëveshje vazhdon të zbatohet për zbatimin e dënimit për personat të cilat janë transferuar në përputhje me dispozitat e saj.
- (4) Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë, me marrëveshje me shkrim ndërmjet Palëve. Çdo ndryshim i tillë hyn në fuqi në përputhje me procedurën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

E përpiluar në SLLOVENI më 28.10.2016 .. në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, serbe, sllovene dhe angleze, me tekst të njëjtë autentik. Në rast të ndonjë ndryshimi në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze..

PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS

PËR REPUBLIKËN E SLLOVENISË

Dhurata Hoxha
Ministre e Drejtësisë



mag. Goran Klemenčič
Ministër i Drejtësisë

